

Udhëzime të rëndësishme për medikamentin Dormicum (Midazolam)

E nderuar paciente, i nderuar pacient

Dormicum (Midazolam) është një medikament për largimin e ankthit, për çlodhje dhe gjumëdhënës, efekti i të cilit zhduket shumë shpejt. Nuk ka efekt uljeje dhimbjesh. Koha, derisa gjysma e medikamentit është zhdukur në trupin tuaj, zgjat rreth 30 minuta. Gjatë trajtimit me Dormicum mund të shfaqet një amnezi (boshllëk kujtimi) e shkurtër.

Në raste shumë të rralla, Dormicum (Midazolam) mund të shkaktojë çrregullim frymëmarrjeje dhe rënie tensioni. Prandaj gjatë gjithë ekzaminimit jeni nën mbikëqyrje. Në rastin e një efekti të papritur anësor, efekti i medikamentit Dormicum (Midazolam) mund të asgjësohet menjëherë përmes dhënies së një kundërhelmi.

E kemi për obligim t'ju udhëzojmë, që pas dhënies së medikamentit Dormicum (Midazolam) aftësia juaj për të ndenjur zgjuar, për përqendrim dhe për pjesëmarrjen në trafikun rrugor është e pakësuar.

Prandaj për 12 orë pas ekzaminimit nuk keni leje për pjesëmarrje

aktive në trafikun rrugor, për drejtimin e mjeteve, për nënshkrimin e dokumenteve të rëndësishme ose për drejtimin e makinerive. Kjo vlen për të gjitha mënyrat e dhënies së medikamentit Dormicum (Midazolam).

Ju rekomandojmë, që rrugën për në shtëpi ta bëni me një person shoqërues.

Mbiemri:	
Emri:	
Datëlindja:	
Pesha:	kg

Ju lutemi përgjigjuni këtyre pyetjeve:

	Po	Jo
■ A vuani nga sindroma "Apne gjumi" (probleme me frymëmarrjen gjatë gjumit)?	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>
■ A keni probleme frymëmarrjeje?	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>
■ A e keni pirë tashme sot një medikament çlodhjeje?	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>
■ nëse Po: Çfarë medikamenti?		

Dormicum i.v.*:		mg	Dormicum Nasenspray*:		Hübe/Seite
Datum*:			Uhrzeit*:		

*plotësohet nga personeli profesional

Nëse keni pyetje të mëtejshme, ju lutemi kërkoni, që këto të përgjigjen nga mjeku ekzaminues ose mjekja ekzaminuese. Ata me kënaqësi ju qëndrojnë në dispozicion për këtë!

Konfirmoj, që jam informuar për efektin dhe rreziqet e medikamentit Dormicum (Midazolam) dhe që do të veproj sipas udhëzimit.

Data:		Nënshkrimi i pacientes/pacientit:		Mjeku:	
-------	--	-----------------------------------	--	--------	--

Dokument muss eingescannt werden.